REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK
02/Nr. Prot. 2-180-2260
Nr. i faq.
Data 03/04/2026

REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK– MUNICIPALITY OF JUNIK

Kuvendi i Komunës
Nr. 002/19
Datë: 31.03.2026

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 pika d) të ligjit për vetëqeverisje lokale (Ligji nr.03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 27 të ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Ligjit nr.03/L-48, GZRK numër 2008/27) dhe nenit 22 paragrafi 22.1 pika 4 të Statutit të Komunës së Junikut (Vendimi i Kuvendit të Komunës së Junikut numër 001/26), Kuvendi i Komunës së Junikut, në mbledhjen e tijë të rregullt të mbajtur më date 31.03.2026 nxjerrë këtë:

VENDIM

për bartjen e të hyrave vetanake të pashpenzuara në vitin 2025 për shpenzim në vitin 2026.

I. Me këtë vendim miratohet propozimi i kryetarit të Komunës së Junikut për bartjen e të hyrave vetanake të pashpenzuara në vitin 2025, për shpenzim në vitin 2026. Shuma e mbetur për bartje është **50,419.96 Euron** ku kërkojmë që bartja të bëhet në këto Programe dhe kategori ekonomike si vijon:

Të hyrat e vitit 2025 – në total prej 50,419.96 Euro bartet si në vijim:

Kategoria e investimeve kapitale **30,419.96 Euro**

- Shuma prej **28,419.96** Euro bartet në kategorinë ekonomike shpenzime kapitale, në projektin me kodin 46030 **"Bashkëfinancim i projekteve"**, në programin Zhvillimi Ekonomik me kod 480, në nën Programin Planifikimi i Zhvillimit Ekonomik me kod 48020.
- Shuma prej **2,000.00** Euro bartet në kategorinë ekonomike shpenzime kapitale, në projektin me kodin 56323 **"Rekonstruim i rrugës "Shkëlzen Gacaferi" Faza I"**, në programin Zhvillimi Ekonomik me kod 480, në nën Programin Planifikimi i Zhvillimit Ekonomik me kod 48020 – Projekt i mbetur obligim nga viti 2025.
- Shuma prej **20,000.00 Euro** të bartet në kategorinë ekonomike, Shpenzime Komunale, në Programin Shërbime publike me kod 180, në nën programin Infrastruktura rrugore me kod 18020.

Në total të hyra për bartje nga viti 2025 në vitin 2026 janë **50,419.96 Euro.**

II. Autorizohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa në realizimin e të gjitha procedurave administrative lidhur me bartjen e mjeteve financiare nga pika I. e këtij Vendimi.

III. Ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse, për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhët zyrtare në web faqen Zyrtare të Komunës së Junikut.

Me këtë vendim njoftohen:

1. MAPL,
2. Ministria e Financave, Punës dhe transfereve,
3. Zyra e Kryetarit,
4. Drejtoria për Buxhet dhe Financa,
5. Shërbimi i Kuvendit të Komunës,
5. Arkivi Komunal.

Kryesuesi i Kuvendit
z. Leonard Lollumi



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK
01/Nr. Prot. 2-155/1661
Një. Org
Nr. i faq.
Data 09/03/2026

REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK– MUNICIPALITY OF JUNIK

DATË/A:	09.03.2026
PËR/ZA/TO:	Leonard Lloluni- Kryesues i Kuvendit Komunal
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Ruzhdi Shehu -Kryetar i Komunës
NGA/OD/FROM:	Ardita Hoxha- Drejtoreshë për Buxhet dhe Financa
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2025 në vitin 2026

Bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, neni 13, neni 58 dhe Statutit të Komunës së Junikut me Nr. 001/3127 të datës 29.09.2010 neni 43 dhe Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal kërkojmë që të bëhet bartja e të hyrave vetanake të pashpenzuara nga viti 2025 në vitin 2026.

Në vitin 2025 janë planifikuar të inkasohen të hyra vetanake në vlerë prej **204,942.00€**, ndërsa shuma e inkasuar për vitin 2025 duke përfshirë edhe te hyrat nga gjobat ne trafik është **166,489.60 €**. Të hyrat e bartura nga viti 2024 në vitin 2025 janë në vlerë prej **108,484.86 €**, ku gjithsej të hyra në vitin 2025 duke i përfshirë edhe te hyrat e bartura janë **274,974.46€**. Nga kjo shumë e të hyrave vetanake gjatë vitit 2025 janë shpenzuar gjithsej **224,554.50€**.

Shuma e mbetur për bartje është **50,419.96 €** ku kërkojmë që bartja të bëhet në këto Programe dhe kategori ekonomike si vijon:

Kategoria e investimeve kapitale **30,419.96€**

- Shuma prej **28,419.96 €** të bartet në kategorinë ekonomike shpenzime kapitale, në projektin me kodin 46030 "**Bashkëfinancimi i projekteve**", në Programin Zhvillimi ekonomik me kod 480, në nën Programin Planifikimi i Zhvillimit ekonomik me kod 48020.
- Shuma prej **2,000.00 €** të bartet në kategorinë ekonomike shpenzime kapitale, në projektin me kodin 56323 "**Rekonstruimi i rrugës "Shkëlzen Gacaferi" Faza I**", në Programin Zhvillimi ekonomik me kod 480, në nën Programin Planifikimi i Zhvillimit ekonomik me kod 48020 – Projekt i mbetur obligim nga viti 2025.

Kategoria e Shpenzimeve komunale **20,000.00€**

- Shuma prej **20,000.00 €** të bartet në kategorinë ekonomike Shpenzime Komunale, në Programin Shërbime publike me kod 180, në nën programin Infrastruktura rrugore me kod 18020.

Në total të hyra për bartje nga viti 2025 në vitin 2026 janë **50,419.96 €**